



# Colours of Albania

#coloursofalbania

## Diplomacia digitale në veprim

### Çfarë është #ColoursofAlbania?

Fushatë mbarëkombëtare dhe konkurs fotografik në mediat sociale për promovimin e Shqipërisë (Instagram, Facebook, Twitter, Web)

### Prezanto me imagjinatë Shqipërinë!

Kjo iniciativë synon prezantimin e imazhit të vendit, duke përcjellë anë e mbanë botës ngjyrat e vërteta të shoqërisë, qytetet dhe fshatrave mahnitëse, bregdetet dhe pejsazhet e paprekura, si dhe pazaret e kështjellat historike të Shqipërisë.

### Konkursi #ColoursofAlbania

Tema është e lirë, duke përfshirë këtu bashkëjetesën fetare, shoqërinë shqiptare, artin, kulturën, etj. Çdo javë do të publikohet tema në faqet e Instagram, Facebook, Twitter, në faqet e internetit të Telekom Albania, të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të përfaqësive shqiptare nëpër botë dhe të institucioneve të tjera publike.

### Kohëzgjatja

Promovimi i #ColoursofAlbania do të fillojë më 27 maj 2016 dhe do të zgjasë deri më 31 korrik 2016. Lançimi i fushatës do të zhvillohet në Qendrën e Telekom Albania (Lounge Bar - me kapacitet 150 persona).

### Pjesëmarrësit

Konkursi është i hapur për të gjithë qytetarët shqiptarë dhe veçanërisht të rinjtë, të apasionuarit pas fotografisë, udhëtimit, artit, kulturës, natyrës, etj.

### Bashkëpunëtorë në promovimin e #ColoursofAlbania

Institucionet Publike: Ministria e Kultures, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, AIDA, Bashkia Tiranë. Personazhe të njohura: Ermonela Jaho, Saimir Pirgu, Kledi Kadiu, Skuadra Kombëtare e Futbollit, Laura Mersini, James Belushi, Elina Duni, Ermal Mamaqi.



#coloursofalbania



# Colours of Albania

#coloursofalbania

## Diplomacia digitale në veprim



### Konkursi

#### Rregullat

- 1.Ndiqni imagjinatën tuaj dhe fotografoni bukuritë e Shqipërisë
- 2.Publikoni fotografitë në profilin tuaj në instagram me hashtag #ColoursofAlbania
- 3.Bëni TAG profilin tonë në Instagram @ColoursofAlbania
- 4.Bëni TAG në Facebook
- 5.Mund të dërgoni fotografitë duke bërë “CHECK IN” vendin ku është marrë
- 6.Mund të dërgoni fotografitë që keni publikuar muaj më parë, mjafton të vendllohi këtë hashtag #ColoursofAlbania

#### Çmimet

- Vendi i parë
- Dy vende të dyta
- Tre vende të treta

Fituesit do të ftohen të jenë prezentë në ekspozitën e fotografisë dhe aktivitetet që do të zhvillohen në kuadër të iniciativës #ColoursofAlbania. Fotot fituese do të jenë pjesë e një bookleti që do të shpërndahet në të gjitha përfaqësítë shqiptare nëpër botë dhe do të përdoret si dhuratë simbol i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

#ColoursofAlbania është projekt i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, mbështetur nga Telekom Albania, dhe synon eksplorimin e temës “Shqipëria është e bukur” nëpërmjet grumbullimit të fotove kreative nga përdoruesit e Instagramit dhe mediave të tjera sociale.



   #coloursofalbania